



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni hetimor i Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga  
Presidenti i Republikës së Shqipërisë”*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 17.05.2021, ora 13:00

**Drejton mbledhjen:**

**Alket Hyseni – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14 maj 2021
2. Marrja e detyrës nga eksperti ligjor, zoti Artan Spahiu
3. Komunikimi i përgjigjeve të institucioneve të tjera dhe prezantim me informacionin e ardhur nga Autoriteti i Medieve Audiovizive
4. Çështje të tjera

**Marrin pjesë:**

Alket Hyseni, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Arlind Çaçani, Elena Xhina, Spartak Braho, Halil Jakimi, Nikolin Staka, Edmond Stojku dhe Eugen Bojaxhiu.

**Mungojnë:**

Myslim Murrizi

**I ftuar:**

Artan Spahiu – Ekspert Ligjor

## HAPET MBLEDHJA

**Alket Hyseni** – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit Hetimor “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”, bazuar në vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Sipas rendit të ditës së lajmëruar, sot në rendin e ditës kemi për diskutim miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 14 maj 2021; marrjen e detyrës nga eksperti ligjor, zoti Artan Spahiu; komunikimin e përgjigjeve të institucioneve të tjera dhe prezantimin me informacionin e ardhur nga Autoriteti i Medieve Audiovizive, si dhe çështje të tjera.

A jeni dakord me rendin e ditës? Ju lutem, shprehuni me ngritje dore.

Të gjithë shprehen dakord.

Miratohet.

Atëherë, kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14 maj 2021.

Të gjithë jeni njohur me procesverbalin. A ka ndonjë koment për procesverbalin, apo ta hedhim në votim?

Kush është dakord me procesverbalin e datës 14 maj 2021? Të gjithë shprehen dakord.

Miratohet.

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës: marrja e detyrës nga eksperti ligjor, zoti Artan Spahiu.

Sekretaria, a është paraqitur zoti Spahiu?

Po, zoti Spahiu, ju lutem, mund të uleni!

Zoti Spahiu, faleminderit që keni ardhur!

Sikurse jeni në dijeni, ky komision hetimor ju ka caktuar në detyrën e ekspertit bazuar në Rregulloren e Kuvendit dhe në ligj, bazuar edhe në CV-në tuaj, po ashtu edhe në deklaratën e lëshuar nga ju pranë këtij komisioni.

Sot këtu do të deklaroni vetëm nëse jeni dakord për marrjen e detyrës.

**Artan Spahiu** – Po, i nderuar zoti kryetar, ju faleminderit për besimin!

E pranoj detyrën si ekspert ligjor pranë komisionit hetimor dhe do të bëj gjithçka, duke vënë në dispozicion të gjithë dijen time ligjore dhe atë kushtetuese për t'iu përgjigjur sa më mirë detyrave që do të më caktojë ky komision.

Ju faleminderit!

**Alket Hyseni** – Faleminderit juve!

Mund të filloni punën. Sekretaria do t'ju vërë në dispozicion detyrat e caktuara nga ky komision.

Punë të mbarë! Suksese!

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës: komunikimi i përgjigjeve të institucioneve të tjera.

Unë jua komunikova edhe në mbledhjen e kaluar, por po ju bëj me dije se në dosje keni shkresën e ardhur nga Bashkia e Tiranës, e cila njofton komisionin hetimor për situatën e ndodhur rreth ekzekutimit të një vendimi nga kjo bashki për lirim të disa ambienteve, të zyrave të një partie politike, procedurë në të cilën ka ndërhyrë fizikisht Presidenti i Republikës.

Ju keni shkresën me nr. 18884/3 të Bashkisë së Tiranës, e protokolluar në Kuvendin e Shqipërisë me shkresën nr. 1081/24, datë 9.05.2021 së bashku me disa dokumente shoqëruese.

Njëkohësisht, sot ka ardhur një informacion shtesë nga AMA, në vijim të informacionit të ardhur më parë, që ka sjellë për këtë komision një sërë kronikash apo lajmesh të dhëna në medien audiovizive.

Shkresat i keni në dosje dhe besoj se të gjithë jeni njohur; janë nisur edhe elektronikisht besoj. Kushdo që ka ndonjë problematikë mund t'ia komunikojë sekretarisë teknike për çdo informacion tjetër.

Për të vijuar, sikurse kemi diskutuar me kryesinë e këtij komisioni, duke qenë se materiali i pamjeve është shumë i madh në numër, është një numër i madh CD-sh në dispozicion, secili nga anëtarët mund t'i konsultojë CD-të dhe mund t'i tërheqë nëse do të ketë nevojë.

Sot kemi përzgjedhur në të kryesisë një sërë kronikash, duke iu referuar atyre kronikave, që kemi përcaktuar edhe në planin e hetimit, por edhe disa nga kronikat e parashikuara apo të përcaktuara në kërkesën për shkarkim të 49 deputetëve.

Mund të fillojmë një nga një. Nuk ka ndonjë rend të përcaktuar.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Po, dakord, me sekretarinë mund të filloni nga shkresa e bashkisë, meqenëse është e freskët dhe e cituam për situatën e konfliktit që folëm.

Faleminderit!

*(Shfaqet kronika e lajmeve e kanalit televiziv “Syri TV”, por nuk dëgjohej qartë)*

**Alket Hyseni** – Po, mund të vazhdojmë me materialin.

*(Shfaqet video tjetër nga intervistat e Presidentit.)*

**“Ilir Meta** - Nuk ka vetëm 3 parti, në këto zgjedhje...”

**Alket Hyseni** – Urdhëro, zoti Braho!

Dëshironi ta japim përsëri?

A mund t’ia plotësojmë këtë dëshirë zotit..?

U emocionuat, zoti Braho me situatën? Unë kam ndierë keqardhje me thënë të drejtën.

Mund ta jepni edhe një herë me kërkesë zotit Braho? Por, sekretaria, CD-ja ka përsëritje të situatave, ashtu ka ardhur apo është?

*(Shfaqet videoja.)*

**“Marsela Karapanço** – Menjëherë në selinë e FRD-së ka mbërritur, gjithashtu, edhe Presidenti Ilir Meta, ku duket se ka tension dhe përplasje. Presidenti Meta është përplasur kështu me policinë.”

*(Transmetohet videoja)*

**Alket Hyseni** – Ju lutem, besoj është mjaftueshëm, zoti Braho. Ju lutem, administratës, nëse ka shprehje jo etike, të papërshtatshme, do t’ju ftoj që në çdo transmetim të gjendet mënyra për të mos u transmetuar, pasi ora është e tillë ku mund të ketë dëgjues të moshave të ndryshme, prandaj ju tërheq vëmendje që duhet të ishit treguar më të kujdesshëm, për videon e parë.

Mund të vazhdojmë me videon e dytë?

*(Transmetohet videoja tjetër.)*

**“Ilir Meta** – Më fal, në këto zgjedhje nuk ka vetëm 3 parti. Në këto zgjedhje janë 20, janë 30, ama detyra e qytetarit është që të gjithë të shkojnë të votojnë, pastaj atje, kur të jenë te kutia, ta vendosin vetë me qetësi. Prandaj, unë u them të gjithë qytetarëve, kush ju ka bërë presion me vendin e punës, apo ju ofron vende pune, kush ju ka kërkuar që të bëni tregti me votën tuaj, ndëshkoheni të gjithë pa mëshirë.

**Marsela Karapanço** - Pazar me votën?

**Ilir Meta** – Po, po. Ndëshkoheni të gjithë. Ndoshta, mund të mos keni forcën, se je qytetar i thjeshtë, një hallelxhi për t’u përplasur me dikë dhe t’ia thuash në sy, por ama atje te kutia e votimit, atje këputini.

**Marsela Karapanço** – Ja, ta dëgjojmë, zotin Basha çfarë thoshte 4 vjet më parë.”

*(Transmetohet videoja tjetër.)*

**“Ilir Meta** – Ato s’kanë gjetur asnjë reagim. Sfurqet i kam parë në Libofshë, në ’94-n. Në 1994-n, kur policia dhe të fortët kanë përdorur dhunë në Libofshë, kanë dalë gratë e

Libofshës dhe i ndiqnin ata dhe iknin me vrap. Sfurqet janë për të dielën në qoftë se preket vota, por duhen evituar këto incidentet e tjera dhe çdo gjë, ama te vota nuk ka më.

**Enton Abilekaj** – Ta marrim pak kronologjikisht.

**Ilir Meta** – Votë sipas Shijakut dhe votë sipas Dibrës nuk ka më, këtë e dinë të gjithë. Të gjithë shqiptarët të jenë gati të mbrojnë votën e tyre. Presidenti është i pari që do mbrojë votën e tyre. Unë shpresoj të ketë reflektuar kryerilindasi dhe ta kuptojë që nuk preket vota e tyre. Nuk ka, meqenëse e përmende, ka qejf ai të spekulojë me ambasadat, sikur i kanë thënë ambasadat vidhni votat. Nuk ka ambasadë në Republikën e Shqipërisë që t'i bëjë strehë kryerilindasit po u prek vota. Kaq. Ama, kryerilindasi mori 71 mandate, në rregull...

**Enton Abilekaj** – S'ka nevojë. Ç'i do ambasadat ai me 71 vota, me blerje votash nuk ka nevojë për ambasadat, as për gjë.

**Ilir Meta** - Ore, nuk ka për çfarë i blen votat ai.

**Enton Abilekaj** – Ambasadat do të dalin të bëjnë deklaratën: “Blenë të gjithë vota”, rezultati njihet dhe mbaroi, siç e bënë në 2017.

**Ilir Meta** - Lekët do i shkojnë dëm. Lekët do i shkojnë dëm.

**Enton Abilekaj** – Ju kujtohet në vitin 2017, kur dilte ambasadori i OSBE-së dhe thoshte u blenë të gjitha votat?

**Ilir Meta** – Po lëre çfarë thoshte ambasadori i OSBE-së në atë kohë, kanë ndryshuar gjërat.

**Bledian Koka** - Çfarë do të ndodhë, zoti President?

**Ilir Meta** - Kanë ndryshuar gjërat, nuk mund të shiten shqiptarët sa një keç, sa një dele dhe sa një lopë.

**Enton Abilekaj** – Kronologjikisht është kjo, ju përmendët sfurqet...

**Ilir Meta** – Unë kam besim te shqiptarët, kam besim te Shqipëria, kam besim se të gjithë janë nisur drejt kutive të votimit për të mbrojtur dinjitetin e tyre, familjet e tyre dhe të kontribuojnë që Shqipëria të jetë e shqiptarëve, jo e Bangladeshit e Indisë e ku di unë.

**Çim Peka** - Zoti President, në qoftë se shqiptarët janë shitur në vitin 2017, pse nuk shiten prapë në 2021?

**Ilir Meta** – Jo, viti 2017 është tjetër gjë. Tani të mos flasim, Çimi, për marrëveshjen e 17 majit që vrau frymën për ndryshim. Tani ka një frymë ndryshimi. Kudo ka një ndërgjegjësime, kudo, edhe Shqipëria do të shkojë në rrugën e duhur. Kaq.

**Enton Abilekaj** – Ju përmendët sfurqet...

**Ilir Meta** – Ore, ka ndodhur kjo gjë në Libofshë, more zotëri, unë ju thashë mos bëni incident sot...

**Enton Abilekaj** – Ambasadorja amerikane dhe përshëndeti, meqenëse keni takuar ambasadoren.

**Ilir Meta** – Po. Unë i kam takuar të gjithë ambasadorët.

**Enton Abilekaj** – Ambasadorja amerikane dhe përshëndeti...”

*(Ndërpritet videoja.)*

**Alket Hyseni** – Po, mund të vazhdoni...

*(Shfaqet video)*

“**Ilir Meta** - ... për të bllokuar integrimin evropian të Shqipërisë, për ta bërë vendin tonë të duket problematik, për të dëmtuar çështjen e Kosovës, që ka qenë ...

Mos u habitni kur kjo gjë të ndodhë. Thjesht keni qenë të paralajmëruar.

**Çim Peka** – Që do ua prisni duart?

**Ilir Meta** – Nëse do t’i zgjasin drejt kutive të votimit.

**Çim Peka** – Megjithatë, unë po kthehem tek ajo që ju pyeti Shkullaku pak më parë. Paralajmëruat bashkëpunëtorët e zotit Rama se “ju që keni shkelur ligjin dhe jeni përfshirë në korrupsion dhe në krim do të përgjigjeni penalisht pasi zoti Rama është i mbrojtur me kartelë”.

**Ilir Meta** – Nuk thashë që është i mbrojtur, por që ai do të mbrohet, do të përpiqet.

**Çim Peka** – Me kartelë?

**Ilir Meta** - Një kartelë është gjithmonë një rrethanë lehtësuese në kuptimin, jo jam i papërgjegjshëm, më zgjodhët vetë. Apo jo?

**Çim Peka** – Kjo është pyetja për ju, zoti President.

**Ilir Meta** - Ata që s’kanë kartë s’kanë asnjë ...

Pastaj, e vendos gjykata rrethanën. Apo jo?

**Andi Bejtja** – Ky është problemi, që e kanë trajtuar si me kartelë dhe i kanë hapur rrugë për tetë vjet.

**Çim Peka** – Zoti President, kur e besuat që kjo kartelë është reale, pasi publikimi i saj ka ndodhur dekada më parë, ndërkohë që ju keni bërë marrëveshje me zotin Rama para tetë vjetëve?

**Ilir Meta** – Besoj se këto tetë vjet kanë qenë më se të mjaftueshme për ta besuar kushdo. Ngjarjet e fundit të aeroportit na bindin më shumë që kemi të bëjmë me probleme të mëdha edhe psikike.

**Çim Peka** – Shkullaku.

**Armand Shkullaku** - Unë këtë e kam gjithmonë paqartësi, por zoti Meta e ka përgjigjen të përhershme. Si ka mundësi që ky bëhet njeri normal kur bashkëqeveris me ju dhe çmendet kur është kundër jush? Vërtet mund të ketë luhatje humori, por nuk i ka çdo tetë vjet.

**Ilir Meta** – Zotëri, nga viti 2013, 2015, deri në zgjedhjet vendore ...

**Armand Shkullaku** – Viti 2007.

**Ilir Meta** – Ajo është tjetër gjë.

Dy vjetët e para qeveria ka qenë relativisht në pozita normale, përgjithësisht, ka pasur eksese, marrëzira, sepse ka qenë në një kontroll të qartë të maxhorancës në parlament, e kështu me radhë. Jo vetëm kaq, por ka qenë edhe në një nevojë jetike për të ruajtur koalicionin me LSI-në në atë kohë deri në zgjedhjet vendore, që të merrte bashkinë e Tiranës, Durrësin, bashkitë kryesore, me rastin e përqendrimit të pushtetit. Pastaj, pati idenë që të merrte të gjithë tepsinë vetëm dhe të përqendrojë të gjitha pushtetet në dorën e tij dhe ...”

*(Shfaqet video)*

**Ernal Sika** - .... elektorale, e cila është në kulmin e saj, finalizohet javën që vjen, të dielën, me zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Në këndvështrimin tuaj, si po ecën fushata?

**Ilir Meta** – Fushata sigurisht që nuk është normale, për arsye se njëra palë, qeveria, bën çdo gjë për të shkelur rregullat e lojës dhe për të luajtur jo vetëm palën në fushë, por edhe arbitrin. Kjo, natyrisht, është shumë e gabuar dhe krijon tensione. Megjithatë, unë jam shpresëplotë që zgjedhjet e datës 25 prill do të jenë demonstrim i vullnetit të popullit shqiptar për ndryshim dhe për të marrë fatet e tij në duart e tij.

**Ernal Sika** – Meqë jemi në qarkun e Vlorës, si e shikoni fushatën këtu?

**Ilir Meta** – Nuk mund të them diçka krejt të veçantë. Kudo ka një lloj tensioni artificial. Tensioni vjen nga qeveria, e cila ndihet pakicë dhe kërkon të imponohet përmes frikësimeve dhe marifeteve të tjera ndaj qytetarëve, gjë që besoj se do të ketë një kundër reagim shumë bindës.

*(Shfaqet video)*

**Çim Peka** - ...kaq rëndësi celularit. Nuk besoj se ju shkruan Yuri Kim?

**Ilir Meta** – Ajo shkruajti dhe unë i dhashë një përgjigje.

**Çim Peka** – Dakord.

**Ilir Meta** – Më tha që duhet të ndaloni për çështjen e sfurqeve dhe unë thashë duhet të ndaloni ...*(nuk dëgjohet)* kundër Kushtetutës.

E ka thënë që më përpara që duhet të bëjmë dialog që të zgjedhim prokurorin me 84 vota, me standarde. Punë e tyre, nuk ka asgjë. Ilir Meta nuk ka asnjë detyrim ndaj Shteteve të Bashkuara për arsye se ka qenë shumë i ndershëm dhe është shumë i pastër me to gjithmonë.

Zonja e nderuar më ka thënë mua që ti ke bërë një letër. Që ta dini ju dhe të gjithë shqiptarët, meqë hyri kjo në këtë lojë, donte të hynte në këtë lojë, ta bëjmë lojë tamam ne. Më ka marrë në telefon. Unë kisha bërë një letër, sepse donin ta fushnin përsëri në KED Dvoranin

këta, ku u them thirrini mendjes, sepse ky nuk është as KLGJ dhe ky është me Venecian e të tjera, por nuk do ta botoja në orën 11:00 që ishte mbledhja, sepse doja të ndërhyja në një vendim të organeve së drejtësisë. Kjo më merr mua në telefon dhe më thotë që ti ke bërë një letër, prandaj ti nesër mos bëj zhurmë po qe se këta e bëjnë kështu. “Zonjë, ne kemi bërë një marrëveshje që do të respektojmë Venecian, - i thashë. - Ky nuk është më as anëtar, se nuk është më anëtar i Gjykatës së Lartë, nuk i takon dhe s’ka se si të jetë këtu, jo andej këtej”. “Po ne dimë ca gjëra për ty”, më thotë mua kjo. Ambasadorja i thotë Presidentit të Republikës “Ne dimë ca gjëra për ty”! “Çfarë dini ju për mua”, i thashë. Nxirrini, thuajuni popullit shqiptar. Unë Kushtetutën nuk e shkel. Marrëveshjen që kemi bërë bashkë ...*(nuk dëgjohet)* nuk e shkel”, i thashë. Unë i thashë kësaj zonjës, le ta dëgjojë ajo tani, meqë e porosit Edi Rama të provokojë Presidentin e Shqipërisë dhe popullin e Shqipërisë, që e do aq shumë Amerikën për demokraci dhe për liri, jo se ka frikë nga kjo dhe njeri tjetër, që e kisha vendosur që këtë letër mund ta publikoja pas vendimit në qoftë se ata merrnin një vendim të gabuar, që të mos ndërhyja, por tani, në orën 11:00 është mbledhja, kurse unë në orën 10:00 do ta publikoj letrën. Ti çfarë ke për mua dhe Amerika çfarë ka për mua, publikojeni, se unë nuk e tradhtoj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe unë këtë vagabond, këtë horr, që e la Shqipërinë pa Gjykatë Kushtetuese, nuk e pranoj kurrë që të hyj atje. Kaq. Kjo është historia.

Unë kam respekt për të. Këtë gjëra ja kam thënë edhe dje në këto zgjedhje do t’i pritet dora në sheshin “Skënderbej” Monika Kryemadhit të parës, që është aty, Lulit të dytit, Edit të tretit dhe të tjerëve që janë aty. Ky është një betim i Presidentit të një vendi, që i ka kapërcyer durimi nga loja me votat, nga dhunimi që u bëhet të drejtave të tij. Në qoftë se ka një bandit, që do të tentojë të bëjë historitë, që kanë ndodhur në Shijak dhe në Dibër do t’ia pres unë dorën, Presidenti i Shqipërisë. Në qoftë se ka një polic, që do të përpiqet të bëjë këto gjëra, një polic i korruptuar, populli do t’ia bëjë atje, bashkë me Presidentin, siç ua bëri policëve të Mubarakut. Në këtë vend, ta dinë mirë, njëherë e përgjithmonë, kushdo nga ata që ke nxjerr aty ti, edhe atë të fundit atje, që jam unë para 10 vjetësh, po u prek një votë, do të pritët një dorë. Kjo nuk është në kuptimin figurativ! Nuk lejoj zhbërjen, shpopullimin dhe shkatërrimin e Shqipërisë në mënyrë, gjoja, demokratike dhe paqësore. Ky është një projekt për ta shpërbërë këtë vend. Unë jua kam dhënë statistikat 1 mijë herë dhe kanë folur për shpopullimin me vite më parë, ashtu siç kam folur për koncesionet para...

*(Në komision shfaqet një video tjetër.)*

**Illir Meta-** ...që ju prishni mitingun që do të bëjë rilindja sot me administratën në Fier. Këtë duhet ta kuptosh qartë. T’i japë edhe disa postera të kryerilindasit, sepse do të shkoj vetë t’ia vë në Fier, përpara se të shkoj në Vlorë, që të kënaqet ai, që të shtohet edhe më tej urrejtja



për këtë provokator të ndyrë, që kërkon të prishë zgjedhjet ditën e dielë. Ky është problemi, Kejdi. Banderolat nuk janë as tuajat, as të LSI-së, as të Arben Çukos dhe të askujt tjetër.

Ndërkohë, bëjuni thirrje të gjitha grave e burrave të Fierit dhe të Mallakastrës t'i mprehin sfurqet, kosoret, sëpatat dhe çfarë kanë ata, sepse i kanë, se janë mjete pune, t'i kenë gati për ditën e diele dhe, po u prek një votë e vetme, siç bënë gratë trime të Libofshës në '94, ashtu do të bëjë të gjithë Fieri dhe e gjithë Shqipëria, me në krye Presidentin. Kjo është çështja, Kejdi. A e kupton pse e bëjnë ata, vagabondë dhe horra, këtë gjë?! Që të dalin militantët tuaj aty, të bëhet sherr i madh, siç bënë në Elbasan atë konfliktin artificial, dhe të krijohet ideja sikur LSI-ja, me porosi të Presidentit, sepse ju çdo gjë e bëni me porosi të Presidentit, prish mitingun e Partisë Socialiste dhe ndonjë diplomat i korruptuar të shkruaj që pati gjëra këtej, por pati edhe probleme nga krahu tjetër, kur ne e dimë shumë mirë se nga vinë të gjitha këto probleme me zgjedhje të lira e të ndershme, sepse ne e dimë se kush e bëri Shijakun dhe Dibrën, që mban peng të gjithë Shqipërinë.

Dua t'i them edhe një herë kryerilindasit: bëre shumë mirë, pas ulërimeve të mia dje, që arrestove tre rrugaçët dhe banditët në Kavajë, të cilët 24 orë para i mbaje me të ngrëna, me të pirë e me garanci. Ti më akuzove mua se nxis dhunë në Kavajë, ndërkohë që ti dhe shtabi yt kriminal i dërgove në Kavajë këta tre horra, dy prej të cilëve punojnë në Bashkinë e Kavajës dhe tjetri, i cili bëri aktin, ishte i lidhur me narkotrafikantë.

*(Në komision shfaqet një video tjetër.)*

**Ilir Meta-** Ky është në planin institucional: t'ia kthejmë Edin Zahos, Lindës dhe familjes së tij, sepse është e qartë që u mungon dhe, ndoshta, në ngrohtësinë familjare ai do të jetë më i qetë, më i dobishëm dhe, njëkohësisht do të ushtrojë pikturën dhe skulpturën e tij.

**Gazetari** – Pra, ju mendoni se mund ta ktheni Edi Ramën në fshatin e vet?!

**Ilir Meta-** Pranë familjes së tij. Përderisa kam pasur ankesa që, për hir të Shqipërisë, ai po sakrifikon, po stresohet dhe atyre u mungon, unë mendoj që në këtë mënyrë zgjidhim dy probleme: problemin e Shqipërisë për 100 vjetët që vijnë, i japim fund një eksperimenti të dështuar, i japim fund populizmit dhe e rikthejmë sistemin demokratik, sistemin e vlerave, shtetin e së drejtës, meritokracinë dhe, njëkohësisht, përcaktojmë qartë rrugën europiane, sepse është vënë në pikëpyetje, por edhe bëjmë një sevap, e kthejmë Edin pranë familjes!

*(Në komision shfaqet një video tjetër.)*

**Ilir Meta-** Unë i shoh në rrezik patronazhistët, sepse njerëzit janë revoltuar shumë dhe po kërkojnë patroazhistët. Kështu që, nuk e shikoj këtë çështje. Është e rëndësishme është që, e biseduam edhe me udhëheqësit e besimeve fetare pak më parë këtu, ne të bëjmë më të mirën,

që të shkojmë në paqe drejt kutive të votimit më 25 prill dhe të gjithë të lutemi për këtë. Unë besoj shumë edhe te roli i udhëheqëseve fetarë...

**Gazetari** - Në fakt, gjatë këtyre ditëve edhe klerikët kanë qenë mjaft aktivë për sa i takon këtij aspekti.

**Ilir Meta**- Ne shqyr që kemi klerikët, ata në çdo rast, ku kanë qenë tensionet më të mëdha në vend, të krijuara politika, ata kanë bërë më të mirën për të qetësuar shoqërinë, për të qetësuar qytetarët. Unë besoj se deri të dielën jo vetëm në Elbasan, por kudo, në të gjithë Shqipërinë, do të japin mesazhet më të mira kundër dhunës, kundër konfliktit, kundër shitblerjes së votës, kundër presioneve, kundër frikës dhe këtë duhet ta bëjmë të gjithë, pasi e them me bindje, mbrojtja e atdheut duhet të jetë te detyrat. Sot mbrojtja e atdheut është që secili të shkojë të votojë dhe të votojë me bindje të plotë për atë alternativë që ai beson, që do t'i respektojë dinjitetin e tij, do t'i respektojë pronën e tij, do t'i respektojë të drejtat e tij civile, qytetare dhe kushtetuese, që do t'i mbrojë familjen e tij, që do t'i garantojë një të ardhme europiane fëmijëve të tij këtu në Elbasan.

**Gazetari** – Të gjitha këto probleme kanë bërë që ju pothuajse të dilnin direkt në një fushatë ndryshe nga të gjithë ...

**Ilir Meta** - Cila është fushata që po bëj unë?!

**Gazetari** – Ka pasur kornizë të caktuar brenda së cilës duhet të qëndrojë Presidenti Republikës, duke qenë se jeni një President i zgjedhur nga parlamenti dhe jo nga populli

**Ilir Meta** – Po, keni shumë të drejtë.

Tani kam një pyetje për ju: çfarë mund të bëjë Presidenti kur e merr kryetari i një parti opozitare dhe i thotë: “Po na nxjerrin nga godina me dhunë, pa asnjë akt, pa asnjë gjë vetëm se kemi firmosur një marrëveshje para dy ditësh me Partinë Demokratike”. Pra, aty krijohet një konflikt dhe Presidenti shkon dhe shikon se çfarë po ndodh aty, siç do të shkoj tani në Kavajë, pasi të mbaroj këtu. *(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Më falni!

Çfarë mund të bëjë Presidenti? Kur shkon Presidenti aty, ti ushtron dhunë ndaj një drejtuesi politik të opozitës në sytë e Presidentit. Pse u nxeh Presidenti?! Po çfarë duhet të bëjë Presidenti?! Të presë që të vriten njerëzit në sytë e Presidentit? Pse?! Sepse ajo parti firmosi një marrëveshje me Partinë e Demokratike. Punë e saj, as nuk e pyetën Presidentin, as nuk u tha gjë Presidenti. Këto janë zgjedhjet e lira, të ndershme dhe të barabarta?!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Më falni, edhe një letër që as elementi më i parëndësishëm i të qenit shkresë zyrtare nuk mund të quhet, përveçse e paligjshme: pa kokë, pa emër, pa titullar, pa asnjë gjë. Ata

kishin një marrëveshje, Bashkia e Tiranës dhe FRD-ja, që për çdo çështje mosmarrëveshje do t'i drejtoheshin Gjykatës Administrative në Tiranë.

Së dyti, për çdo hap të njëanshëm do të përqeshin që ta zgjidhnin çdo gjë me marrëveshje, në rast se jo, të paktën 20 ditë para, do ta lajmëronin njëri-tjetrin për veprimet që do të bënin, nuk ka rëndësi. Pse kjo dhunë?! Pse ky presion?! Çfarë duhet të presë Presidenti, që të bëhet e gjithë Shqipëria Shijak?! Pra, sipas zgjedhjeve në Shijak.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pastaj për çfarë u duhet shqiptarëve Presidenti?!

Mandatin e parë e donte, sepse i duhej tepsia vetëm, apo jo?

Ky sa herë që ka zgjedhje muajin e fundit fillon e thotë Partia Socialiste, nuk thotë rilindja. Pasi ua merr socialistëve, siç jua merrte atëherë, sepse tani nuk ua merr dot, prandaj është bërë nervoz, thotë ne jemi rilindës, nuk jemi socialistë, ne jemi pa parti, e kështu me radhë merret me ato trillet e veta jashtë partisë. Unë nuk kam këtë shqetësim, ajo është çështja e tij. Presidenti shikon në rrezik shtetit, sepse shteti, si çdo qytetar e ndien dhe e kupton, është tërësisht larg qytetarit.

Po marr disa raste, pastaj të kalojmë në Kavajë dhe ku të doni, Presidenti i dërgon shkresë zyrtare, ku i thotë: “Zoti Kryeministër kini kujdes sepse do të bjerë tërmet”, ku i citon edhe shkencëtarin, që ka paralajmëruar të gjithë mediet botërore. Presidenti duhet të shqetësohet për këtë gjë, apo jo. Ja ndodhi?! Inshallah nuk ndodh, por ja ndodh, ashtu siç ndodhi. Pastaj, kur paralajmëron ai shkencëtari, më i madhi...”

**Alket Hyseni** – Duke qenë se është një numër i madh me CD-i, janë dhjetëra CD-i që kanë ardhur dhe ndoshta mund të kemi edhe të tjera në vijim, këto ishin disa nga CD-të e para, nga pamjet e para, që janë përzgjedhur nga ne si kryesi për t'u njohur ju, si anëtarë.

Unë e thashë edhe në fillim, dua të ftoj secilin nga anëtarët që të njihet me të gjithë volumin e pamjeve. Administrata teknike do të përpiket që të përzgjedhë pamje që i paraqesin raste të caktuara, për të mos bërë përsëritje, pra aq sa është bërë e mundur, për të mos dhënë të njëjtat deklarata, pavarësisht në media të ndryshme, por e rëndësishme është t'u referohemi të gjithëve atyre që ngrihen në shqetësimin e 49 deputetëve apo të tjera që mund të vijnë nga institucionet. Megjithatë, secili nga ju, nëse njihet me këtë volum dhe dëshiron që ndonjë nga ato pamje, që nuk është transmetuar apo nuk është shfaqur *live* në komision, mund ta fusim pa asnjë problematikë. Thjesht doja t'ju sqaroja që është e pamundur për efekt kohe që ne të transmetojmë këtu të gjithë volumin e pamjeve të ardhura. Ju lutem, njihuni me pamjet dhe çdo kërkesë specifike juaja mund të përcillet në kryesinë e këtij komisioni ose drejtpërdrejtë në administratë dhe do të shqyrtohet për t'u paraqitur në mbledhjet e ardhshme. Ne patjetër që

do të kemi transmetime të tjera në mbledhjet e ardhshme. Nuk e di nëse janë bërë gati nga ana teknike dy të tjerat. Në rregull, mund t'i transmetoni edhe ato dhe më pas mund të diskutohet rreth këtyre që u transmetuan deri tani, për të vijuar në mbledhjet e ardhshme.

Gati?

Këto janë statuse në faqen zyrtare të Presidentit të Republikës, më sqaron sekretaria e komisionit, të cilat janë pa zë, por janë tekste.

Mund të kaloni tek tjetra.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Këto janë besoj.

Kush ka diskutime rreth këtyre provave që u shfaqën?

Po, zonja Bushka.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Në fakt, dua të sjell në vëmendje të kolegëve që referuar kërkesës, që kanë bërë 49 kolegët tanë deputetë, për nisjen e procedurës së shkarkimit të Presidentit në argumentet që japin, nëse e keni kërkesën përpara është lidhja numër 1, pra në lidhjen numër 1 citohen të gjitha materialet ku bazohen argumentet e kolegëve.

Ju vë në dukje se një pjesë e materialeve kanë të bëjnë me emisione televizive apo me deklarata nga studio televizive. Një pjesë tjetër janë postime në *Facebook*. Nëse do të duhet t'i shikojmë të gjitha postimet në *Facebook*, unë mendoj se mund të printohen nga sekretaria dhe ne t'i shikojmë.

Për pjesën e materialeve audiovizive, që kanë ardhur nga AMA, të gjithë kolegët duhet t'i kenë në *email-in* e tyre personal, sepse gjithsekush duhet t'i shikojë vetë, nuk është çështja që vetëm t'i shfaqim këtu. Ne mund të qëndrojmë me orë të tëra, zoti kryetar, do t'i shikojmë të gjitha, pa diskutim, por nuk mendoj se me një herë të parë është e mjaftueshme.

Për efekt të procedurës së komisionit dhe të transparencës, pa diskutim që ne i shfaqim, por është mirë që edhe anëtarët e komisionit t'i kenë këto në *email-et* zyrtare personale.

Për hir të transparencës dhe për të qartësuar edhe një herë se cilat janë materialet filmike, që janë kërkuar nga AMA dhe që një pjesë u shfaqën sot, do të më duhet t'i lexoj, sepse është e rëndësishme edhe për kolegët.

**Alket Hyseni** - Po, po mund t'i lexoni!

**Klotilda Bushka** – Atëherë, kemi emisionin “*Frontline*” në News 24, datë 1 mars 2021. Më 23 mars 2021 në “Syri Televizion”. A mund t'i lexoj edhe tekstet apo i keni përpara në kërkesë dhe vetëm t'i rendisim?

**Alket Hyseni** – Disa nga tekstet edhe mund t'i lexoni.

**Klotilda Bushka** - Po vazhdoj me këtë. Atëherë teksti i parë më 1 mars 2021 në emisionin “*Frontline*” në News 24. Këto janë të zbardhura në kërkesë, por për saktësi do të duhet të kemi ato që kanë ardhur nga AMA. Gjithsesi në kërkesë lexohet: “ Ndëshkoni pa mëshirë më 25 prill këdo që ju bën presion me votën, këdo që tenton t’ju blejë votën, këdo që ju ka mashtruar. Një votë po u prek, do të pritët një dorë. Nëse Rama fiton 71 mandate me votë të lirë, unë do të jap dorëheqjen nga posti i Presidentit. Nëse ai merr 71 mandate pa prekur votën e popullit, unë kaloj në opozitë dhe marr drejtimin e opozitës. Kushdo që do të guxojë në emër të popullit të prekë votën, do t’i pres dorën në emër të sovranit. Vetëm populli shqiptar me votën e tij do të mbrojë demokracinë”.

Vijojmë me “Syri TV”, emisioni i datës 23 mars 2021: “Tani *live* sapo më shkruajti ambasadorja Juri Kim për të mos përmendur më sfulqet. I them ambasadores amerikane *live*, që të mos marrë më në mbrojtje Edi Ramën. Meqë më dërgoi *live sms*, i them ambasadores: “Mos e mbështet më Edi Ramën”.

Meqë jam transparent, po ju them edhe një fakt: ambasadorja amerikane më ka kërkuar mua, si President, një ditë para mbledhjes së KED-së të pranoj Adrian Dvoranin. Këtë ajo ma kërkoi jo në emër të Amerikës, por në emër të Edi Ramës. E përqafoj ambasadoren amerikane dhe i them: “Boll ndërhyre në punët e brendshme të Shqipërisë në këtë mënyrë të njëanshme! Deklarata e Juri Kim është një turp dhe e ftoj ambasadoren të vijë tani *live* në studio bashkë me Edi Ramën për t’u ballafaquar para shqiptarëve. Më 25 prill votojnë dëshmorët”.

Më datë 1 mars 2021 “*Frontline*” në News 24: “Unë nuk merrem me punët e Amerikës, sepse kemi dikë tjetër që merret me punët e Amerikës dhe të të gjithë botës. Unë merrem me punët e Shqipërisë. Se sa respekt ka ai për SHBA-të, e tregoi kur ua hodhi në fytyrë marrëveshjen e 5 qershorit. Unë kam shumë respekt për SHBA-të. Unë jam President i Shqipërisë. Amerikanët e Edi Ramës, Ilir Meta i kap për veshi, jo Presidenti se Presidenti është tjetër fuqi, se ka fuqinë e popullit shqiptar. E di ai sesi u flas unë atyre, kur ata nxijnë dhe bëjnë maskarallëqe për llogari të Edi Ramës. Dhe po i them që të mos i përmend më ata dhe të mos gënjejë as veten, as ata të mos e gënjejnë, se do t’i dalin ata për Zot po preku një votë të lirë: vota është e shenjtë dhe do të jetë e shenjtë nga 25 prilli e për 100 vjet”.

“Të ekspozuarit” nga Ylli Rakipi, më 11 mars 2021: “Ka ardhur koha të rikthejmë një sistem demokratik dhe institucional në vend të populizmit. Ky është regjim autokratik, por jo serioz, sepse ka edhe regjime serioze. Të gjitha pushtetet i ka futur ai në xhep. Popullin nuk e fut dot në xhep. Kemi edhe rastin e Kirgizistanit. Unë nuk besoj se zoti Rama mund të bëjë zgjedhje të ndershme. Nuk ka bërë zgjedhje në parti. Shembuj të tjerë nuk kemi çfarë të japim më. Rama është pjesë e këtij komploti ndërkombëtar 20 - vjeçar kundër Shqipërisë. Unë e kam

bërë të qartë që jemi në betejë me një mafie ndërkombëtare, që do të zhbëjë Shqipërinë. Askush në botë nuk del dot kundër një populli. Unë kam kohë që luftoj kundër një mafieje ndërkombëtare. As nuk më kërcet fare për sa kam dalë këtu, jo vetëm që i dal zot vetes sime, por edhe qytetarëve. Unë jam president i votës për atë që kam të drejtë.

Tani, ndjesë, nëse edhe unë, në kuadrin etik, po citoj fjalë që në përditshmërinë time nuk do t'i përmendja, por jam e detyruar për t'i qëndruar korrekt kërkesës së deputetëve:

12.3.2021. Peka live, në zyrat e FRD-së: “Po i them kryepalaços së bashkisë-bandë, mos iu bind urdhrave të të çmendurit, sepse ai do të nxjerrë kartelën e të sëmurit psikik. E konsideroj si një përpjekje për grusht shteti t'i sjellësh një partie zyrtare opozitare menjëherë pasi nënshkruan një marrëveshje me PD-në dhe partitë e opozitës për të marrë pjesë në zgjedhje, një shkresë të tillë që nuk ka as vulë, as emër titullari për të mbajtur përgjegjësi nesër, të bërë me vrap e nxitim, vetëm për të dhunuar fizikisht, por edhe psikologjikisht çdo forcë opozitare.

Vazhdojmë. 15.3.2021 “Çim Peka live” – Ky është një ballafaqim midis instalimit të autokracisë dhe kleptomanisë në këtë vend në shërbim të interesave të të tjerëve. Rama është thjesht një peng i tyre. Ministria e Drejtësisë sot duhej të ishte në burg. Përgjigjen që ende nuk e ka marrë nga drejtësia do ta marrë më 25 prill nga qytetarët e Tiranës.

20.4.2021, intervistë në TV1 Channel: “Të gjithë ne e dimë se Kryeministri është me probleme të mëdha mendore dhe psikike, i evidenton edhe më shumë tani nga tmerrri i afrimit i ditës së të vërtetës. Ky karagjoz nuk ka se çfarë të dijë për mua se, nëse do të dinte diçka, që do të kishte dalë në një debat, se e kam ftuar vazhdimisht, ai do të frikësojë qytetarët shqiptarë. Patronazhistët janë duke u fshehur se kanë frikë se i kapin qytetarët dhe u thonë se përse na i keni marrë të dhënat. Ata që kritikojnë janë servilë ... , që dërgon nëpër televizione ata që i mban me lekët e inceneratorëve. Në rast se Rama fiton 71 mandate pa prekur votën, Ramës do t'ia jap edhe mandatin tim si President. T'i marrë të gjitha, ta marrë edhe Presidencën, të vërë atje një kukull. Nëse populli do të votojë Ramën, unë nuk kam pse rri edhe një vit kot”.

Konferencë për mediet, 22.4.2021, këtë nuk kemi pse e citojmë, sepse e keni të zbardhur të gjithën, por mund të lexoj nënvizimet e kolegëve:

“Kjo është reforma në drejtësi e Edi Ramës që thotë Ilir Meta do ta ndryshonte reformën në drejtësi.

Nuk e ndryshon dot rezultatin e zgjedhjeve.

A e keni parë raportin e medieve, cila është partia më e diskriminuar, burim i tensionit në Shqipëri? Është Edi Rama, i cili ka kapur drejtësinë, do të blejë votat dhe ta bëjë gjithë Shqipërinë Shijak dhe Dibër.

U bëj thirrje ndërkombëtarëve, të jenë më parimorë dh të reagojnë në kohë.

Nëse nuk do të kishin pranuar shkeljen e marrëveshjes së 5 qershorit, situata do të kishte qenë më e mirë prej kohësh.”

1.4.2021. ABC News. “Ilir Meta nuk pyet për gangsterët, nuk pyet për mafien ndërkombëtare dhe as për diplomatë të korruptuar. Mendon vetëm për Shqipërinë dhe për respektimin e Kushtetutës, madje edhe sot kam një paralajmërim të prerë për ju, në veçanti për mafien ndërkombëtare, të bëjnë kujdes sepse Shqipëria nuk është një vend eksperimental.

Kandidati me numrin 17 në listën e PS-së Tiranë duhej të ishte në burg, jo kandidat për deputet, por aty është për të blerë vota.”

2.4.2021. Është postim në Facebook. “E kam paralajmëruar prej kohësh qeverinë ende në detyrë të heqë dorë nga arroganca dhe të tërhiqet nga çdo vendim abuziv dhe jashtë procedurave ligjore ndaj investorëve të huaj në vendin tonë. Vetëm për tekat dhe kapriçot personale të Kryeministrit, i cili e urren edhe lirinë e medias tashmë Shqipëria është detyruar të paguajë 110 milionë euro.”

21.4.2021. Është postim në FB. Po jap vetëm citimin e kolegëve, të cilën e kanë theksuar në kërkesë. “Asgjë nuk e ndalë triumfin e vullnetit të sovranit që përmes referendumit të 25 prillit, do të përmbysë fuks-shtetin e Rilindjes dhe do të rivendosë shtetin e të drejtës dhe llogaridhënies.

Të gjithë ju, zyrtarë, që nuk keni kartelë psikike, mos e rëndoni pozitën tuaj duke shkelur ligjin dhe kodin në ditët dhe orët që vijnë. Të gjithë ju të fortë që po përdoreni nga pushteti kriminal për presione dhe blerje votash, bëhuni gati se edhe pulat do t’ua sekuestrojmë.

Kush prek votën e 25 prillit, ka sulmuar sovranitetin e popullit të Republikës së Shqipërisë dhe do të trajtohet si armik i Republikës dhe i Kushtetutës.

Kush shet votën, shet nderin e familjes, nuk e meriton të quhet njeri dhe kurrsesi shqiptar. Përpara, me qetësi dhe vendosmëri drejt qendrave të votimit për Shqipërinë europiane, që ristarton fuqishëm me 25 prill. Shqipëria do të jetë e shqiptarëve përjetësisht.

8.4.2021. Syri TV.

Është një intervistë. Gazetari: A keni listuar emrat që do t’ua prisni duart?

Presidenti: Pa asnjë diskutim që kjo do të ndodhë dhe mos u habitni kur të ndodhë. Keni qenë të paralajmëruar nëse do t’i zgjasin duart drejt kutisë së votimit. Besoj se këto 9 vjet kanë qenë më se të mjaftueshme që kemi të bëjmë me probleme të mëdha psikike të Edi Ramës.

12 prill 2021. Postim në *Facebook*.

16.4.2021. Intervistë në TV 6+1, Vlorë

Qeveria po bën çdo gjë në këto zgjedhje për të prishur standardet, pasi po bën edhe palën, edhe arbitrin në fushë, por jam me besim se populli do të marrë në dorë fatet e tij. Ka një tension artificial që vjen nga maxhoranca dhe kjo ndodh për shkak se ndihen pakicë. Ajo kërkon të imponohet përmes marifeteve, por do ta ketë të pamundur.

Fushata që po zhvillohet nuk është e qetë.

17.4.2021. Post në *Facebook*

“Dy foto të pabesueshme nga Gjirokastra, që m’i nisi miku i shtrenjtë i demokracisë shqiptare, Martin Henz. Asnjë shqetësim për psikopatinë tuaj, zoti rilindës, por nëse vërtet e besoni që unë jam në garë për 25 prillin, mos më detyroni të hyj vërtetë, pasi do të mbeteni pa grup parlamentar. Pale, po mora edhe doktorin e madh, nuk ka spital që ju bën derman. Ndaj respektoni Kodin Zgjedhor. Boll e tepruat me shkelje, se i nxitë faqen Shqipërisë para botës!”

18.4.2021. Postim në FB.

Të dashur patronazhistë,

Mos e dëgjoni kryefuksin se regjimi i fuksave ka mbaruar. Kryefuksi e di më mirë se kushdo tjetër nga djali i atij që firmosi varjen e poetit Hafzi Nela dhe për të cilin u shpreh krenar se ishte në anën e duhur të historisë, shqiptarët nuk mund të presin asnjë reflektim dhe garanci për respektimin e shtetit ligjor dhe të drejtave kushtetuese. Të gjithë me qetësi dhe vendosmëri drejt 25 prillit! Referendumi për rivendosjen e demokracisë do të triumfojë shumë bindshëm”.

Postim në *Facebook* 19.03.2021; postim në *Facebook* 03.03.2021; deklaratë për mediet e Presidentit të Republikës së Shqipërisë 05.03.2021; postim 10.03.2021. Unë nuk po i lexoj postimet, se i keni të zbardhura, postim 05.03.2021. Në datën 17.03.2021 është letër drejtuar KQZ-së për ngjarjet në Elbasan dhe zyrat e FRD-së. Letrën e keni bashkëngjitur, këtë e lexoni vetë.

Deklaratë 19.03.2021: “Shqipëria zbrazet, bizneset mbyllen, por administrata fryhet”.

Në kushtet kur ritmet dramatike të shpopullimit të vendit nuk i ndali as pandemia, kur situata ekonomike në vend rezultoi më e rënda prej vitit 1991 dhe sipas të dhënave zyrtare, të paktën 50 mijë vende pune janë mbyllur për shkak të COVID-19, fryrja e administratës shtetërore me punësime të reja fiktive në prag të zgjedhjeve të 25 prillit ka përparuar ndjeshëm.

Përdorimi i shtetit për qëllime elektorale është një tjetër dëshmi serioze dhe skandaloze e degradimit dhe e komprometimit të reformës në administratën publike nga ana e Kryeministrit ende në detyrë. Më 25 prill jam i bindur se të gjithë qytetarë do të marrin pjesë masivisht në referendumin historik për të ndëshkuar njëherë e përgjithmonë degradimin e administratës, shpërdorimin e taksave të buxhetit, si dhe për të realizuar ç’kapjen e shtetit”.



Publikim në *Facebook* 07.04.2021. Aeroporti i Rinasit. “Qeverisë së 1 Prillit do t’ia jap sot pasdite nga Vlora përgjigjen për çështjen e aeroportit të Rinasit, si çështje shumë e rëndësishme e sigurisë kombëtare dhe e detyrimeve ndërkombëtare.

Nëse është hapur aeroporti i Vlorës, konferencën e shtypit do ta bëjmë atje, por nëse jo, në një ambient tjetër të përshtatshëm për të cilin gazetarët do të njoftohen në kohë.

Ftohet dhe “Tërmeti” të marrë pjesë për shkak të përvojës së tij me aeroportet, fluturimet dhe jo vetëm”.

10.04.2021. Deklaratë për mediat. Parku Kombëtar, Apolonia, Fier.

Ju lutem, të më falni një sekondë, se kam shkëputje fletësh. Po e kalojmë këtë.

Atëherë, po kaloj të postimi në *Facebook* më 16.04.2021

“Mosmbështetja e bujqësisë dhe e fermerëve është e pafalshme dhe rrënja e braktisjes së fshatrave dhe e shpopullimit të vendit. Edhe ato pak fonde "mjerane" të përcaktuara nga buxheti për bujqësinë, e që janë 10 herë më pak se fatura, që do t'i paguhet Bechetit, harxhohen në pjesën dërmuese për spote, konferenca, panaire dhe "kotësira" korruptive. Plot 60% e parave të subvencioneve shkojnë për pagesa jo produktive. Ndërsa vetëm "thërrimet" përfundojnë te fermerët, të cilët të braktisur punojnë dhe prodhojnë me kosto 40% më të lartë se fqinjët në rajon. Prandaj 25 prilli, është referendum popullor për shumë më tepër para dhe mbështetje për bujqësinë dhe fshatin.

Intervistë me gazetarin Fatmir Popja në televizionin “Skampa” më 19.04.2021.

“Po i shoh në rrezik patronazhistët, sepse tani të gjithë janë vënë në kërkim të tyre. Unë u bëj thirrje qytetarëve që të ruajnë qetësinë dhe të dëgjojnë mesazhet e mençura të klerikëve tanë fetarë për të shkuar paqësisht drejt 25 prillit. I shoh në rrezik patronazhistët, sepse njerëzit janë nervozuar shumë dhe po kërkojnë pikërisht ata. Çfarë mund të bëjë Presidenti kur sheh se ka akte dhune?! Çfarë duhet të presë Presidenti, që e gjithë Shqipëria të jetë si Shijaku dhe Dibra?! Kjo kurrë nuk ka për të ndodhur. Sot mbrojtja e atdheut është detyrë mbi detyrat. Mbrojtja e atdheut është që të gjithë qytetarët të shkojnë të votojnë më 25 prill. Vota e tyre do të sigurojë të ardhmen, mbrojtjen e familjes dhe të ardhmen e fëmijëve të tyre. Vota e 25 prillit do të vendosë ligjin dhe do të mbrojë të drejtat dhe liritë e tyre”.

Postim, datë 20.04. 2021

“Të dashura nëna, baballarë, të nderuar prindër dhe veteranë!

Pavarësisht mundit, punës dhe sakrificave tuaja shumëvjeçare, për herë të parë, pas më shumë se 20 vitesh, pagesat e pensioneve tuaja jo vetëm nuk u rritën, por u ulën me 3,2%.

Në fakt, ulja e vërtetë e tyre shkon rreth 5% me inflacionin, sepse me paratë e sakrificave dhe kontributeve tuaja fuksë, shteti do të paguajë rreth 10 mijë patronazhistë, që

gjurmojnë dhe "gërmojnë" në jetën tuaj private dhe atë të rreth 900 mijë qytetarëve të vendit. Prandaj, 25 prilli është referendum edhe për nënat, edhe baballarët për t'u çliruar nga abuzimi dhe nëpërkëmbja e të drejtave të tyre”.

Postim, datë 21.04.2021

“E përgëzoj kandidatin Belind Këlliçi për kapjen në flagrancë të "rilindësve" të Vaqarit, me ushqime dhe zarfe elektorale. Opozita duhet të organizohet në mënyrën më të mirë për të parandaluar këto fenomene kriminale, elektorale, nga të cilat kryerilindësit nuk shkëputet dot”.

Postim, datë 23.04.2021

I keni bashkëlidhur kërkesës të gjitha, por unë po lexoj për të kuptuar se cilët janë postimet, që duhet t'i shqyrtoni veçmas dhe cilat do të jenë deklaratat e zbardhura.

Është një postim i datës 23.03.2021: “As pandemia nuk e ndali shpopullimin e Shqipërisë. Me kurajë dhe me besim te vota e lirë, me pjesëmarrje masive në zgjedhje, të çelë një epokë të re të ndërtimit të së ardhmes sonë të sigurt europiane, për të nxjerrë nga intubimi demokracinë, për t'i dhënë frymëmarrje lirive dhe të drejtave të njeriut. Do ta çlirojmë Shqipërinë nga thonjtë e oligarkëve, banditëve dhe arrogantëve”.

Postim më 11.3.2021; postim më 3.2.2021, postim më 10.3.2021; intervistë për “News 24” në emisionin “Kjo javë”.

Pyetja: Duke qenë se kjo është intervista juaj e parë për vitin 2021, cili është mesazhi për shqiptarët dhe për politikën shqiptare?

Përgjigjja e Presidentit: “Për qytetarët shqiptarë mendoj se duhet të marrin të gjithë më shumë përgjegjësi, duhet vënë përpara përgjegjësisë politikanët e papërgjegjshëm që kanë bllokuar zhvillimin e vendit, kanë dëmtuar situatën ekonomiko-shoqërore të familjeve shqiptare, kanë vënë në pikëpyetje të ardhmen e këtij vendi, interesat kombëtare dhe publike. Çdo qytetar duhet ta kuptojë që ndryshimi është vetë ai dhe ndryshimi fillon te pjesëmarrja në zgjedhje”.

Status në *Facebook* më 25 prill 2021: “Shqipëria pret një përmbysje të madhe jo thjesht një rotacion”. Në fakt, ky është statusi dhe jo data e statusit.

Menjëherë pas pikës 37 të kërkesës ka një pikë tjetër, Presidenti Meta status në *Facebook*, në të cilën thuhet: “Nga zgjedhjet e 25 prillit 2021 Shqipëria pret një përmbysje të madhe jo thjesht një rotacion”. Data e statusit këtu mungon.

Kemi një postim më 28.1.2021; post në *Facebook* më 22.11.2020, por këto janë të periudhave të mëparshme, 23.12.2020; 18.11.2020 dhe më pas janë të gjitha postimet në *Facebook* në pikën 44 të lidhjes 1 të kërkesës së kolegëve tanë deputetë. Bëhet fjalë edhe për një postim tjetër të datës 10.10.2020, një postim tjetër e datës 20.2.2020 dhe më pas është një

intervistë me gazetaren Beti Njuma, në datën 18.2.2020; postim në *Facebook* më 15.10.2020; 18.10.2020 po prapë postim në *Facebook*; intervistë për “ABC News” më 24.12.2020; postim në *Facebook* më 22.2.2020.

Gjithashtu, edhe ajo e datës 25 prill 2021 është postim dhe thuhet: “Demokracia do të triumfojë mbi oligarkinë dhe qytetaria mbi marrëzinë. Presidenti ka vetëm një votë si çdo qytetar i këtij vendi, do të votojë kundër oligarkisë që ka nëpërkëmbur Kushtetutën, ligjet dhe të drejtat e njeriut dhe që po mban peng të ardhmen europiane të vendit”.

Konferencë shtypi e Presidentit Meta, më pas është në datën 28.10.2020 në “Quo Vadis” në “Vizion Plus” zbardhja e një pjese të intervistës dhe më 29.1.2020 është një postim. Prononcim për mediet nga Shkodra më 6.2.2020; prononcim nga Korça më 8.2.2020; intervistë për emisionin “Faktor” në RTSH Korça më 10.2.2020; postim në *Facebook* më 10.2.2020; 13.2.2020 dalje për mediet në Sarandë; 18 dhe 20 shkurt 2021 postime në *Facebook*; dalje mediatike për ligjin e koncesionit po në datën 24.2.2021; post në *Facebook* më 25 shkurt në lidhje me mesazhin e komisioneres për të Drejtat e Njeriut, *Dunja Mijatoviç* dhe më 26.2.2021 prapë postim.

Në fakt, ka disa gabime në kërkesë, pasi ka disa raste ku referohet data 2020, por nëse i referoheni përmbajtjes dhe posteve janë për vitin 2021.

Kjo është me pak fjalë lidhja 1.

Lidhja 2, në kërkesën e kolegëve tanë deputetë, ka të bëjë me përmbledhjen e artikujve në media të rasteve të dhunës së territorit dhe vetëgjyqësisë së militantëve të motivuar nga mesazhet, si dhe deklaratat e institucioneve publike si KQZ-ja apo të tjera, në lidhje me ngjarjet e dhunshme që ndodhën gjatë fushatës elektorale.

Unë nuk ju lexova edhe shumë zbardhje të intervistave, sepse janë faqe të tëra, prandaj që në fillim të fjalës sime i kam kërkuar sekretarisë së komisionit hetimor që një set të të gjitha materialeve që kanë ardhur nga Autoriteti i Medieve Audiovizive t’u shkojë në një formë të kuptueshme dhe të qartë të gjithë kolegëve të komisionit në mënyrë që secili të ketë kohën e mjaftueshme për t’i parë.

Edhe nëse unë zgjodha të lexoja disa zbardhje, ndërkohë që disa janë shumë të gjata, ne prapë nuk do të mundemi dot që të kuptojmë apo të krijojmë një bindje nga ky lloj referim. Është shumë e nevojshme që në momentin që ju pajiseni me të gjitha informacionet zyrtare të ardhura, gjithsekush të marrë kohën e vet për t’i kuptuar dhe më pas ne mund t’ia nënshtrojmë, sipas fazave procedurale diskutimit mbi aktet e marra në kuadër të procesit hetimor.

Faleminderit!

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zonja Bushka!

Ishte e nevojshme të citoheshin një nga një, të paktën materialet e paraqitura në kërkesën e 49 deputetëve, të cilat janë administruar dhe po administrohen të gjitha nëpërmjet AMA-s. Doja të sqaroja që, në kuptimin e të provuarit, janë zyrtare dhe automatikisht kanë vlerën e provës.

Përtej kësaj, sapo u njoftova nga sekretaria që ka ardhur përgjigjja nga Gjykata Kushtetuese, me shkresën nr. 1081/27, datë 12.05.2021, ku paraqitet një korrespondencë e Gjykatës Kushtetuese me Presidenten e Republikës. Ka një shkresë me nr. 1209, datë 05.04.2021 e Presidentit të Republikës. Kjo korrespondencë është gjykuar e nevojshme lidhur me faktin nëse ka apo jo ndërhyrje nga Presidenti i Republikës ndaj këtij institucioni të rëndësishëm kushtetues. Secili nga anëtarët mund të njihet me të, është një shkresë e zakonshme, nuk është sekret, ndërkohë sekretaria duhet të bëjë fotokopjimin dhe t'ua bëjë me dije të gjithë anëtarëve të komisionit.

Njëkohësisht, në dosjen tuaj është shtuar një informacion i dytë nga Drejtoria e Kërkimit Parlamentar dhe Shërbimi i Bibliotekës, ku keni të gjithë bazën ligjore, jo vetëm tonën, por të një numri të caktuar vendesh, të cilët kanë parashikuar në Kushtetutën e tyre bazë ligjore apo referime për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Ka ndonjë diskutim rreth provave që u shfaqën dhe propozimit të zonjës Bushka?

**Edmond Stojku** – Faleminderit, zoti kryetar!

U njohëm me materialet që kanë ardhur nga Drejtoria e Kërkimit Parlamentar dhe nga institucionet pas kërkesës që kemi bërë ne si komision hetimor. Unë i falënderoj për korrektësinë e tyre!

U bë kaq kohë, në fakt, që në opinionin publik diskutohet mënyra e dhënies së nënshtetësisë nga Presidenti i Republikës. Duke marrë shkas nga Kërkimi Parlamentar, rasti i presidencës lituaneze, njëkohësisht edhe shkarkimi i Presidentit të Lituanisë pikërisht për këtë proces, mendoj që në objektin e hetimit të komisionit hetimor parlamentar të shtohet ndoshta edhe kjo pikë, e cila ka qenë një pikë shumë e nxehtë diskutimi mediatik, e opinionit publik prej të paktën dy vjetësh.

Nuk do të ishte keq që të kërkonim bashkëpunimin edhe të institucionit të Presidencës, e cila të na vinte në dispozicion pikërisht të gjitha këto materiale, që të shohim nëse ka apo jo shkelje të ligjit, sepse në fund fare këto janë fakte reale, nëse janë të dokumentuara, të cilat mund të na japin të drejtën e një vendimi të mbështetur në fakte dhe prova, për të qenë më të drejtë dhe të saktë në vendimin që do të marrim.

**Alket Hyseni** – Ju falënderoj, zoti Stojku!

Sa i takon kërkesës suaj, do të doja t'ju bëja me dije që objekti i veprimtarisë së këtij komisioni është në tagrin e Kuvendit, jo të vetë komisionit, kështu që, nëse do të keni ndonjë kërkesë mund ta paraqisni në seancën plenare.

Për sa i takon afatit, brenda së cilit e ushtron veprimtarinë ky komision dhe periudhën për të cilën ai kontrollon nëse ka shkelje të rënda nga Presidenti i Republikës, ne mund t'i drejtojmë ndoshta një kërkesë Presidentit të Republikës, që për këtë periudhën para zgjedhjeve, gjatë zgjedhjeve nëse ka procedura të dhënies së nënshtetësisë, të shohim si janë ndjekur ato. Por, përtej këtij afati, jemi jashtë objektit të veprimtarisë dhe objektin nuk mund ta ndryshojmë vetë. Besoj se do të gjej mirëkuptimin tuaj në këtë aspekt.

Nga ana tjetër, nëse komisioni e çmon, mund t'i drejtojmë një kërkesë ekstra Presidentit, pasi i kemi çuar një kërkesë për marrje provash zyrës së Presidentit dhe në dijeninë time ende nuk kemi një përgjigje, ndoshta janë duke e përpunuar. Pra, mund t'i çojmë edhe një kërkesë për të gjithë volumin e punës së kryer lidhur me dhënien e shtetësisë në periudhën ku ne mund të kontrollojmë ligjshmërinë e veprimeve të Presidentit të Republikës.

Po, zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Faleminderit, zoti kryetar!

Realisht nuk do të isha dakord me sa parashtruat, pasi ne jemi nisur nga një kërkesë e 49 kolegëve deputetë dhe e kemi ngritur këtë komision për të shqyrtuar kërkesën e tyre dhe ata i kanë përcaktuar konkretisht pikat ku duhet të bazohet kjo kërkesë dhe nuk kemi asnjë indicio, që të mund të jetë dhënë ndonjë nënshtetësi gjatë këtij afati që ne kemi marrë në shqyrtim si komision hetimor.

Në këto kushte, nuk do të isha dakord të zgjeronim objektin e hetimit, për sa kohë jemi të fokusuar tek objekti i kolegëve deputetë dhe i kërkesës së tyre.

Faleminderit!

**Alket Hyseni** – Zonja Xhina, së pari, nuk parashtrova asgjë, kështu që nuk keni pse të jeni apo të mos jeni dakord me mua, sepse unë të kundërtën e asaj që ju menduat se kontestuat thashë. Jemi në një mendje, ne nuk e ndryshojmë dot objektin.

Nga ana tjetër, ushtrimi i kompetencave të Presidentit të Republikës edhe për shtetësinë, është një nga detyrat, e cila mund të hetohet për këtë periudhë, sikurse në vendimin e Kuvendit nuk është specifikuar se cilat kompetenca. Çdo veprim i Presidentit të Republikës në këtë periudhë është apo jo në përputhje me ligjin dhe Kushtetutën, përbën apo jo shkelje të Kushtetutës, ky është qëllimi i këtij komisioni për këtë periudhë, pa e kufizuar. Kërkesa ka ngritur një sërë pretendimesh, por Kuvendi na ka adresuar tashmë për të kontrolluar të gjithë veprimtarinë e Presidentit të Republikës për periudhën që kemi objekt. Në këtë këndvështrim

nuk ka pengesë. Pjesa e objektit ka pengesë, pjesa e ushtrimit të kompetencave, si komision për këtë periudhë, nuk ka asnjë pengesë.

A ka ndonjë tjetër koment, apo ndonjë mendim rreth provave që u paraqitën?

**Klotilda Bushka** – Jam dakord me zonjën Xhina. Në fakt, arsyeja pse ky komision hetimor vepron është sepse vendimi i Kuvendit ka përcaktuar objektin e punës së tij në vijim të miratimit të procesit, i cili është kërkuar nga 49 kolegët tanë deputetë për ato arsye dhe shkaqe të listuara në atë kërkesë. Nëse do të duam ta zgjerojmë objektin e aktivitetit të këtij komisioni hetimor, nuk jemi ne që mund ta bëjmë, por është Kuvendi i Republikës, i cili vendos mbi bazën e një kërkesë që ushtrohet nga jo më pak se ¼-ta e deputetëve në lidhje me objektin e punës së tij. Jemi në një fazë ku ne, si komision hetimor, e kemi detyrën tonë të qartë. Ne hetojmë ato shkelje, në vijim të të cilave Kuvendi ka vendosur të ngrihet ky komision. Gjithsesi më duhet të them edhe një herë atë të tha zoti Hyseni, që, në fakt, ajo që po hetojmë, si komision hetimor, ka të bëjë më ato shkelje të pretenduara nga kolegët tanë, që konsiderohen si shkelje të rënda të Kushtetutës dhe që mund përlligjin shkarkimin e Presidentit, që lidhen me periudhën para dhe gjatë zgjedhjeve, si dhe në kuadër të zgjedhjeve të 2021-it. Aktiviteti i Presidentit lidhur me shtetësitë, apo me dekretimet nuk hyn në objektin e kërkesës së këtij komisioni, por gjithsesi e drejta e kolegëve, si deputetë, qëndron që ne mund t'i ndërmarrim edhe nismat përkatëse për ta shtuar. Po ju them që faktet dhe rrethanat mbi të cilat kolegët tanë deputetë janë nisur për të bërë kërkesën për shkarkimin e Presidentit, në bazë të së cilës ne jemi ngritur me vendimin e Kuvendit, lidhet me pjesën e parë që ju keni në planin e hetimit. Në planin e hetimit, nëse e shihni në faqen 1, thuhet qartë: “Presidenti i Republikës gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore, ka kryer akte dhe deklarata, të cilat, në mënyrë të përmbledhur dhe të renditur, janë...” dhe nëse i vini re është 25 prilli 2020, sepse më parë unë ju lexova lidhjen nr. 1, por në pjesën e argumenteve, fakteve dhe rrethanave që paraqesin kolegët tanë, janë në mënyrë të përmbledhur se cilat janë ato akte, për të cilat ata kanë kërkuar këtë proces hetimor. Për shembull, në deklaratën e 28 prillit 2020 thuhet “Kërcënimi i fundit që vjen përmes Tao Taos nga banda e Elbasanit dhe të gjithë Shqipërisë...” ka vetëm një përgjigje: “Presidenti gati për të firmosur dekretin për mbrojtjen e Republikës. Shqipëria e shqiptarëve. Vdekje tradhtarëve!”.

24 prill dita e heshtjes zgjedhore. “Të dashur prokurorë gjyqtarë, dëgjojeni mirë Presidentin e Republikës! Boll dëgjuat përfaqësuesin e Ndrangheta-s, Don Agaçon. Nëse jo, një pikë gjaku të derdhet nesër, por edhe një pikë loti njeriu, mjerë ju... Nesër duhet të jetë festa e demokracisë”.

24 prill, dita e heshtjes zgjedhore: “Kriminelët janë kudo të rrezikshëm, por më të rrezikshëm janë kriminelët e veshur me uniformë, janë ata që gjenden brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorisë, prandaj thirrini mendjes, zbatoni ligjin, qëndroni larg ndikimeve politike! Mos u bëni palë, ruani integritetin e detyrës! Përmbushni detyrën pa asnjë vonesë dhe mos e detyroni popullin t’ju arrestojë në flagrancë përmes ligjit, që Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar! Presidenti i Republikës është gjithmonë me Kushtetutën dhe sovranin, Presidenti i Republikës është gjithmonë gati për të marrë përgjegjësinë për çdo dekret në mbrojtje të zgjedhjeve, demokracisë, popullit nga dhuna e oligarkisë. Nesër duhet të jetë festë demokracie”. Ose më 24 prill, përsëri dita e heshtjes zgjedhore. “Sfurqet do të jenë të dielën nëse preket vota. Zgjedhje si të Shijakut dhe të Dibrës nuk do të ketë më, kjo histori ka marrë fund. Unë kam besim te shqiptarët. Të gjithë janë nisur drejt kutive të votimit për të sjellë ndryshimin historik, duke e çuar Shqipërinë në rrugën e duhur”.

20 prill: “Lidheni të marrin, shokë socialistë, përpara se të ketë fatin e furgonit në Berat. Pse, Meta u tha 3 banditëve të rilindjes të hynin në zyrën elektorale të PD-së dhe të qëllonin me armë sekretarin demokrat? Me kë janë në foto këta të katërt? Me Metën, apo me kryebashkiakun e emëruar, rilindas të Kavajës, dhe shtabin e tij elektorale? Pse Meta e porositi Damianin publikisht të përsërisë tërmetin e Dibrës në Vlorë? Meta e emëroi një ushtri patronazhistësh për të mbikëqyrur dhe shantazhuar 900 mijë qytetarë të qarkut të Tiranës? Kush e prishi marrëveshjen e 5 qershorit nga tmerrin e zgjedhjeve të lira? Babëlok, shqiptarët e dinë shumë mirë ku kurdisesh ti për t’i përçarë shqiptarët në Shqipëri dhe rajon. Me qetësi dhe vendosmëri do të marrësh përgjigjen më 25 prill nga të gjithë shqiptarët patriotë dhe europianë dhe, në radhë të parë, nga socialistët që shkatërrojnë çdo vlerë pozitive dhe njerëzore. Unë do të shkoj në shtëpi, kur ti të shkosh në psikiatri. Shqipëria e shqiptarëve, Shqipëria në BE. Pas 25 prillit kjo rrugë nuk ndalet më asnjë sekondë”.

19 prill: “Bravo qytetarëve të Beratit! Gjejini, izoloni, mos i toleroni! Nuk ka patronazhistë fuksa dhe banditë, që të mund të ndalin ndryshimin e madh më 25 prill. Ngrihuni dhe bjeruni, korrini dhe shtypini, katundarë e punëtorë që nga Shkodra gjer në Vlorë! Me qetësi drejt 25 prillit!”

13 prill: “Gropat e zeza të inceneratorëve të mafies i thithën 100% paratë e planifikuara për financim nga taksapaguesit në 2020-n, ndërkohë që pjesa tjetër e projekteve të menaxhimit të mbetjeve shfaqin realizim të dobët, që shkon deri në 9%, prandaj 25 prilli është referendum popullor kundër mafies së inceneratorëve të plehrave dhe kandidatëve të saj”.

11 mars: “Kërkoj nga çdo qytetar shqiptar të tregojë respekt për veten dhe të besojë se fuqia e tij në demokraci është vota. Erdhi koha t’ua kthejmë Edin Lindës dhe Zahos, të cilëve u mungon aq shumë”.

1 mars. “Detyra e qytetarit është të votojë”, “Unë i them qytetarit: “Kush ju ka bërë presion në vendin e punës, kush ju ka blerë votën, ndëshkoheni me votë”. “Unë nuk kam asnjë interes as se çfarë ka thënë apo çfarë thotë njëri apo tjetri”. “Më 26 prill ma ndërroni emrin, ma vendosni si të doni”. “Nëse një votë do të vidhet, do t’u pritet dora në sheshin “Skënderbej”, Kryemadhit të parës dhe të tjerëve”. “Ky është një premtim i Presidentit të këtij vendi”. “Nëse ka një bandë që do të tentojë të bëjë blerjen e votave si në Shijak dhe Dibër, do t’ia pres unë dorën”. “Unë Presidenti i Shqipërisë, një votë të vidhet do të pritet një dorë”, nuk është në kuptimin figurativ”

Më pas janë deklaratat përkatëse të 24 shkurtit që janë: “Kapja e shtetit është nevojë ulëritëse për të ardhmen europiane të Shqipërisë dhe për të ndalur shpopullimin e saj”. “Demokracia është kontroll i sovranit mbi të zgjedhurit dhe jo zgjedhja e oligarkisë mbi qytetarët dhe dhunimi i të drejtave të tyre kushtetuese”. “Dëshmova sot përballë qytetarëve të republikës një rast flagrant të kapjes së shtetit nga sektet në pushtet, me urdhër të kryeoligarkut në pushtet, që ka kapur çdo institucion publik dhe tmerrohet nga zgjedhjet e lira dhe rivendosja e llogaridhënies demokratike”. “U bëj thirrje të gjithë deputetëve të reflektojnë për këtë koncesion sa më parë”. Deklarata e fundit, më 20 shkurt: “Janë shqetësuar nga mesazhet e Presidentit, le të shqetësohen, le të tmerrohen të gjithë ata, të cilët mendojnë se do të bëjnë tërmet në zgjedhjet si në Dibër apo në Shijak, qofshin këta qeveritarë, punonjës policie, qofshin bandit, qofshin gjithçka”.

Këto janë në njëfarë mënyre faktet dhe rrethanat në kërkesën e kolegëve deputetë. Siç e shikoni, lidhen me aktivitetin në kuadër të funksioneve mbi zgjedhjet, pra brenda periudhës së zgjedhjeve. Prandaj ajo që tha zoti Hyseni në fillim të mbledhjes, në cilësinë e kryetarit, ne jemi në tagër të përcaktuar sipas objektit të vendimit të komisionit, sigurisht që mund të na japë të drejtën, por nëse do të ketë një vendim të seancës plenare të Kuvendit në përputhje me procedurat për ta shtuar objektin.

Faleminderit!

**Alket Hyseni** – Urdhëroni, zoti Stojku!

**Edmond Stojku** – Nga materialet që ka dërguar Kërkimi Parlamentar ka ardhur rasti i Presidentit të Lituanisë dhe unë nga këtu mora shkas. Unë nuk e kisha menduar më parë, por nga leximi i materialeve të sjella nga Kërkimi Parlamentar, ku Presidenti i Lituanisë shkarkohet



pikërisht për këtë, pra hyn në një nga rastet e drejtësisë, ku kryetarët e shteteve shkarkohen, mendova që nuk është çudi të jetë në objektin e komisionit hetimor si gjithë të tjerët.

**Alket Hyseni** – Po.

Duke iu referuar edhe vendimit të Kuvendit për ngritjen e komisionit, pika 3, germa “c”, ku përcaktohet edhe verifikimi i akteve, i sjelljeve dhe i qëndrimeve të caktuara të Presidentit të Republikës në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese, referuar edhe germës “a”, ku flitet për periudhën para dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe ditën e heshtjes zgjedhore, pra për një afat të caktuar, nisur edhe nga e drejta juaj, që ju jep neni 13 i ligjit “Për komisionet hetimore” që një kërkesë e një deputeti për marrje prove nuk hidhet në votim, por pranohet, atëherë mendoj se duhet pranuar për këtë periudhë. Unë mendoj se mund t’i nisim një shkresë Presidentit vetëm për këtë periudhë, për të mos e hapur më tej. Nëse do të ketë dhënie shtetësie, le t’i shohim, por vetëm si informacion dhe jo si objekt pune, sepse nuk e kemi si objekt pune. A biem dakord, zoti Stojku?

*(Nuk dëgjohet.)*

Atëherë, në rregull.

Po, zoti Braho, a keni diçka për të shtuar?

**Spartak Braho** – Numërova me shumë kujdes të gjitha deklaratimet e Presidentit që u relatuan në mediet elektronike, si dhe në postimet personale që ka bërë ai herë pas here, dhe janë rreth 40 denoncime, të cilat janë me përmbajtje kriminale, në shkelje të ligjit për shumë çështje që lidhen me zgjedhjet, me zhvillime të tjera, që lidhen me korrupsionin, me komplete, me akuza e fyerje në adresë të shumë personaliteteve shtetërore dhe të përfaqësuesve të diplomacisë ndërkombëtare. Këto janë konstatimet e Presidentit.

Shtrohet çështja: a i është drejtuar Presidenti atëherë, apo dhe tani ndonjë organi shtetëror, ligjzbatues për t’i paraqitur këto denoncime? Në dijeninë time jo. Por kjo duhet hetuar. Nuk mund të hedhësh akuza, ti je President, duhet të respektosh organet ligjzbatuese, sepse ato që ndjekin, hetojnë, procedojnë dhe arrestojnë, nuk ndjek, nuk procedon, nuk arreston dot njeri tjetër, qoftë ky dhe President, lidhur me këto akuza.

Pra, çështja është: a ka denoncime të tilla në organet shtetërore ligjzbatuese nga ana e Presidentit? Këto nuk ishin pyetje për ju, i dashur kryetar, unë e kuptoj, por që duhet ta ndjekim si procedurë.

**Alket Hyseni** – Dakord, zoti Braho.

Shqetësimi juaj është i drejtë. Kjo zgjidhet duke i drejtuar një shkresë Presidentit. Ne u kemi drejtuar njëkohësisht disa institucioneve, atyre të cilave kemi pasur indicie nëpërmjet kërkesës apo opinionit publik. Unë mendoj që t’ia drejtojmë drejtpërdrejt Zyrës së Presidentit,

bashkë me pjesën tjetër të kërkimit për informacion, ku t'i themi që për këtë periudhë për të cilën ne veprojmë, pra për periudhën zgjedhore, ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve, të na vënë në dispozicion korrespondencën që ka pasur Presidenti i Republikës me këdo institucion të shtetit shqiptar. A jeni dakord me këtë, zoti Braho?

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

Po, ato që kanë lidhje me objektin? Po thotë që ka ngritur disa shqetësime, logjikshëm duhet t'ua kishte nisur institucioneve. E kuptoj shqetësimin tënd...

**Spartak Braho** – Po, nëse nuk kthen përgjigje?

**Alket Hyseni** - Nëse nuk kthen do të thotë se nuk respekton institucionin e parlamentit, por kjo është një çështje tjetër, mos ta paragjykojmë.

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

Është vetëm një institucion, por ka shqetësime të tjera. Pra, mund të jetë policia, mund të jetë Shërbimi Informativ, mund të jetë KQZ-ja...

*(Deputeti Spartak Braho flet pa mikrofon)*

Pyetja juaj merr përgjigje vetëm në këtë mënyrë, zoti Braho!

A jeni dakord?

Po, urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Lidhur me sjelljet e Presidentit të Republikës do të doja të sillja edhe një herë në vëmendje objektin e komisionit tonë hetimor, i cili është komision për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese. Në objektin e punës së këtij komisioni janë tri fusha: e para, është hetimi dhe verifikimi nëse aktet dhe deklaratat e dhëna gjatë periudhës para dhe gjatë fushatës dhe ditën e heshtjes përbëjnë shkelje të rënda të Kushtetutës, si dhe të gjitha filmimet dhe ato çfarë lexoi kolegja Bushka, të cilat na janë vënë në dispozicion të printuara, por edhe në llogarinë tonë *online* në *email* për këtë gjë.

E dyta, është verifikimi i pasojave të akteve në raport me parimin e unitetit, prishjen e ekuilibrit politik, pra të këtyre akteve që lidhen gjithmonë bashkë.

E treta, është verifikimi i akteve, i sjelljeve dhe i qëndrimeve të caktuara të Presidentit në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese.

Pra, nisur nga sugjerimi që ngriti zoti Stojku, por edhe nga shqetësimi që ngriti zoti Braho mund të verifikojnë nëse Presidenti i Republikës ka dhënë shtetësi brenda kësaj periudhe. Pra, së pari, duhet vërtetuar lidhja me këtë proces.

Së dyti, ne sipas kalendarit e kemi thirrur Presidentin e Republikës të dëshmojë dhe në bazë të kalendarit ditën e nesërme Presidenti i Republikës ka të drejtë të jetë i pranishëm në

komision dhe të dëshmojë. Secili nga anëtarët e komisionit ka mundësi që t'i bëjë pyetje dhe ne të marrim përgjigje. Nëse, për shembull, nga përgjigjet që mund të japë Presidenti i Republikës ose nga dokumentet shkresore që do të depozitohen në komision, nuk marrin përgjigje pyetjet e kolegëve, ne mund t'ia kërkojmë një gjë të tillë në dëgjuesë për t'i paraqitur para këtij komisioni parlamentar.

Faleminderit!

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zoti Çaçani.

**Arlind Çaçani** – Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse ne po kërkojmë informacione shtesë nga Presidenti i Republikës, unë do të sugjeroja që, përveç informacioneve që u parashtruan këtu, të kërkonim informacion për periudhën që po hetojmë për dhënien e dekoratave.

**Alket Hyseni** – E kemi kërkuar.

**Arlind Çaçani** – Më falni!

Ju kërkoj ndjesë!

**Alket Hyseni** – Kjo është kërkuar nga sekretaria, por ende nuk kemi marrë përgjigje. Pra, është kërkuar ky informacion nga ana e Presidentit për dhënien e titujve dhe dekoratave, kështu që është ezauruar.

A ka ndonjë shqetësim tjetër?

Atëherë, duke qenë se i kemi ezauruar pikat e rendit të ditës, a ka dikush diçka për të thënë jashtë rendit të ditës? Nuk ka.

**Vasilika Hysi** – A keni marrë ndonjë konfirmim nga Presidenca për nesër?

**Alket Hyseni** - Deri tani nuk ka asnjë konfirmim nga Presidenti i Republikës, por ne seancën e kemi caktuar dhe është një seancë dëgjimore me Presidentin e Republikës nesër. Përveç kësaj, në rast se koha do të na lejojë, do të kemi edhe vijimin e procedurës për shfaqjen e provave të tjera audiovizive. Ndërkohë, unë i kërkoj sekretarisë, për aq sa është e mundur nga pikëpamja teknike, që në *email*-in e çdo deputeti, në *WhatsApp* apo në çdo formë tjetër të kalojë çdo material që ka ardhur nga AMA. Po ashtu, sikurse ka nisur sot procedura për publikimet në faqen zyrtare të Presidentit apo të zyrtarëve të Zyrës së Presidentit, sepse çdo gjë duhet të jetë e administruar, t'u bëhet me dije deputetëve në rrugë elektronike. Kush i dëshiron, përveç rrugës elektronike, edhe të fotokopjuara, mjafton t'i kërkojë.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ju falënderoj për bashkëpunimin sot!

Ndoshta u zgjatëm duke transmetuar këto prova, por ishin të domosdoshme për t'u njohur jo vetëm anëtarët e komisionit, por edhe publiku, pasi kjo është edhe detyra jonë që të jemi transparentë në raport me publikun në këtë rol që kemi në përgjithësi, si edhe në këtë mision delikat që ka ky komision. Të mos harrojmë se puna që bëhet gjatë kësaj mbledhjeje është vetëm një pjesë e vogël e punës së madhe që bëjnë anëtarët e këtij komisioni dhe ky komision vetë me verifikimin e provave, si dhe hulumtimin e tyre për të krijuar secili nga këta anëtarë bindjen e tij të pavarur nëse jemi para shkeljeve të rënda kushtetuese nga ana Presidentit të Republikës, apo jo.

Edhe një herë faleminderit!

Ditë të mirë dhe punë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Kryetar**  
**Alket Hyseni**

**Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Sekretare e komisionit**  
**Evi Naku**